LIGJ
Nr. 79/2026

PËR MBYLLJEN E SHOQËRIVE TREGTARE ME KAPITAL SHTETËROR NË LIKUIDIM

Në mbështetje të neneve 78, pika 1, 81 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është mbyllja dhe çregjistrimi përfundimtar i shoqërive tregtare me kapital shtetëror në likuidim, si dhe përcaktimi i mekanizmit për trajtimin, administrimin dhe kalimin e të drejtave dhe detyrimeve të tyre.

Neni 2
Fusha e zbatimit

1. Ky ligj zbatohet për shoqëritë tregtare me kapital shtetëror jo më pak se 51%, të cilat ndodhen në proces likuidimi në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji.
2. Shoqëritë tregtare me kapital shtetëror që shpallen në proces likuidimi pas hyrjes në fuqi të këtij ligji vijojnë procedurat e likuidimit sipas ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

Neni 3
Përkufizime

Për qëllime të këtij ligji termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:
1. "**Shoqëri tregtare me kapital shtetëror në likuidim**" është çdo shoqëri tregtare në të cilën shteti, drejtpërdrejt ose tërthorazi, zotëron jo më pak se 51% të kapitalit, për të cilën është marrë vendimi për prishje dhe është hapur procedura e likuidimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. "**Mbyllje e shoqërisë**" është procesi i përfundimit të likuidimit, transferimit të të drejtave dhe detyrimeve, sipas këtij ligji, dhe çregjistrimit të shoqërisë nga Qendra Kombëtare e Biznesit.
3. "**Shoqëria shtetërore pasuese**" është shoqëria tregtare shtetërore e krijuar në zbatim të këtij ligji, e cila administron asetet dhe detyrimet e transferuara nga shoqëritë në likuidim.
4. "**Detyrime të pakërkueshme**" janë detyrimet për të cilat, bazuar në dokumentacionin financiar dhe juridik të disponueshëm, rezulton se kreditori nuk ekziston, nuk është i identifikueshëm, ka hequr dorë nga kërkesa ose për të cilat nuk është paraqitur kërkesë për një periudhë të gjatë dhe nuk ekziston mundësi reale për ekzekutim.
5."**Detyrime të parashkruara**" janë detyrimet për të cilat ka kaluar afati i parashkrimit, sipas legjislacionit civil në fuqi.
6. "**Transferim ligjor**" është kalimi i të drejtave dhe i detyrimeve nga shoqëritë në likuidim tek shoqëria shtetërore pasuese, i realizuar drejtpërdrejt, në bazë të këtij ligji.

7. “**Asete**” janë pasuritë e luajtshme e të paluajtshme, të drejtat pasurore dhe çdo interes tjetër ekonomik në pronësi ose në administrim të shoqërive në likuidim.

KREU II
PROCEDURA E MBYLLJES SË SHOQËRIVE TREGTARE ME KAPITAL SHTETËROR NË LIKUIDIM

Neni 4
Procedura e mbylljes së shoqërive tregtare me kapital shtetëror në likuidim

1. Asambleja e Përgjithshme e shoqërive tregtare me kapital shtetëror në likuidim vendos fillimin e procedurës së çregjistrimit sipas parashikimeve të këtij ligji.
2. Të drejtat dhe detyrimet e shoqërive tregtare shtetërore në likuidim transferohen nga shoqëritë ekzistuese tek shoqëria tregtare shtetërore e krijuar, në zbatim të këtij ligji.
3. Pas përfundimit të transferimit të të drejtave dhe detyrimeve, Asambleja e Përgjithshme merr vendimin për mbylljen përfundimtare të shoqërive tregtare shtetërore në likuidim, si dhe autorizon çregjistrimin e tyre në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Neni 5
Inventarizimi

1. Shoqëritë tregtare shtetërore në likuidim që u nënshtrohen parashikimeve të këtij ligji kryejnë një vlerësim të plotë ekonomiko-financiar, si dhe përgatitin raportin përfundimtar të mbylljes, i cili përfshin detyrimisht:
a) listën e detyrimeve dhe kërkesave për arkëtim;
b) listën e detyrimeve dhe kërkesave për arkëtim të parashkruara;
c) listën e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme;
ç) dokumentacionin tekniko-ligjor përkatës.
2. Raporti përfundimtar i mbylljes, i parashikuar në pikën 1 të këtij neni, i përcillet shoqërisë shtetërore pasuese për administrim dhe trajtim të mëtejshëm, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Në kuadër të procedurës së mbylljes, detyrimet debitore dhe kreditore të parashkruara, për të cilat rezulton se nuk ka pretendime bazuar në dokumentacionin shoqërues, fshihen nga regjistrat kontabël të shoqërive tregtare shtetërore në likuidim.

Neni 6
Çregjistrimi në Qendrën Kombëtare të Biznesit

1. Pas përfundimit të transferimit të të drejtave dhe detyrimeve, shoqëritë tregtare me kapital shtetëror në likuidim çregjistrohen nga Qendra Kombëtare e Biznesit.
2. Për qëllime të çregjistrimit, në Qendrën Kombëtare të Biznesit depozitohen:
a) vendimi i Asamblesë së Përgjithshme për mbylljen përfundimtare të shoqërisë;
b) pasqyrat financiare të mbylljes së shoqërisë në likuidim.
3. Qendra Kombëtare e Biznesit kryen çregjistrimin e shoqërive tregtare me kapital shtetëror në likuidim, në përputhje me parashikimet e këtij ligji.

KREU III
SHOQËRIA SHTETËRORE PASUESE

Neni 7
Krijimi i shoqërisë shtetërore pasuese

1. Për qëllime të këtij ligji dhe për administrimin, trajtimin dhe menaxhimin e aseteve e të detyrimeve të mbartura, krijohet shoqëria tregtare shtetërore "Operatori i Shoqërive Shtetërore" sh.a.

2. Aksionari i vetëm i shoqërisë është ministria përgjegjëse për ekonominë, e cila ushtron të drejtat dhe kompetencat përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Organizimi, përbërja e organeve drejtuese, funksionimi dhe kompetencat e shoqërisë "Operatori i Shoqërive Shtetërore" sh.a. do të përcaktohen në aktin e themelimit dhe statutin e shoqërisë, në zbatim të legjislacionit në fuqi.

4. Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë:

a) administrimin e aseteve të transferuara;

b) shitjen ose privatizimin e tyre, sipas legjislacionit në fuqi, me qëllim shlyerjen e kreditorëve. Për shitjen apo privatizimin e aseteve që mund të kenë rëndësi strategjike apo mund të cenojnë sigurinë kombëtare paraprakisht merret miratimi nga ministritë përgjegjëse. Procedura për shitjen ose privatizimin e aseteve të shoqërisë përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

c) arkëtimin e detyrimeve debitore;

ç) sistemimin në kontabilitet të detyrimeve debitore dhe kreditore të parashkruara ose të pakërkueshme.

5. Trajtimi dhe shlyerja e detyrimeve të transferuara kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi, sipas radhës së përparësisë së përcaktuar në Kodin Civil.

6. Shoqëria e krijuar, sipas këtij neni, zëvendëson shoqëritë e mbyllura në të gjitha marrëdhëniet juridike me palët e treta, duke përfshirë të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga këto marrëdhënie.

7. Organizimi, përbërja e organeve drejtuese, funksionimi dhe kompetencat e shoqërisë "Operatori i Shoqërive Shtetërore" sh.a., mënyra e financimit dhe administrimit të tij përcaktohen në aktin e themelimit dhe statutin e shoqërisë, që miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

8. Shoqëria ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin për shoqëritë tregtare dhe me aktet nënligjore në fuqi.

Neni 8

Kapitali fillestar i shoqërisë shtetërore pasuese

Kapitali fillestar për themelimin e shoqërisë tregtare shtetërore "Operatori i Shoqërive Shtetërore" sh.a. mbulohet nga buxheti i shtetit. Masa e kapitalit fillestar përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 9

Efektet mbi likuidatorët dhe organet ekzistuese

1. Me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme për mbylljen përfundimtare të shoqërive tregtare me kapital shtetëror në likuidim, sipas këtij ligji, përfundojnë automatikisht kompetencat e likuidatorëve dhe të çdo organi tjetër drejtues të shoqërive të mbyllura.

2. Veprimet dhe aktet e kryera nga likuidatorët deri në momentin e mbylljes përfundimtare konsiderohen të vlefshme, për aq kohë sa nuk bien në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji.

Neni 10

Mbrojtja e palëve të treta dhe e drejta e ankimit

1. Kreditorët dhe çdo palë e tretë që pretendon se preket nga transferimi i të drejtave dhe detyrimeve, sipas këtij ligji, kanë të drejtë të paraqesin kërkesat ose pretendimet e tyre pranë shoqërisë shtetërore pasuese, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Para mbylljes përfundimtare të shoqërive tregtare me kapital shtetëror në likuidim, njoftimi për fillimin e procedurës së mbylljes publikohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit, me qëllim informimin e kreditorëve dhe të palëve të treta.

3. Kreditorët dhe palët e treta kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre në gjykatën kompetente për çdo veprim që cenon të drejtat e tyre si kreditorë, në përputhje me legjislacionin procedural dhe civil në fuqi.

4. Transferimi i të drejtave e i detyrimeve, sipas këtij ligji, nuk cenon të drejtat e kreditorëve dhe të palëve të treta për të kërkuar përmbushjen e detyrimeve, sipas marrëdhënieve juridike ekzistuese.

Neni 11

Mbrojtja e të drejtave të aksionarëve

1. Transferimi i të drejtave dhe detyrimeve të shoqërive tregtare me kapital shtetëror në likuidim te shoqëria shtetërore pasuese, sipas këtij ligji, nuk cenon të drejtat pasurore të aksionarëve.

2. Pas përfundimit të procesit të likuidimit dhe shlyerjes së detyrimeve ndaj kreditorëve, çdo vlerë neto e mbetur nga asetet e shoqërisë u shpërndahet aksionarëve në përpjesëtim me pjesëmarrjen e tyre në kapitalin e shoqërisë së likuiduar, në përputhje me legjislacionin në fuqi për shoqëritë tregtare.

3. Aksionarët kanë të drejtë të kundërshtojnë në gjykatën kompetente çdo veprim ose vendimmarrje që cenon të drejtat dhe interesat e tyre pasurore, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 12

Dorëzimi i dokumentacionit

1. Dorëzimi i dokumentacionit administrativ, financiar, ligjor dhe teknik nga shoqëritë tregtare me kapital shtetëror në likuidim tek shoqëria e re e krijuar, sipas këtij ligji, kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Dorëzimi i dokumentacionit kryhet me procesverbal, i cili nënshkruhet nga likuidatorët e shoqërive të mbyllura dhe nga administratori i shoqërisë përfituese.

3. Përgjegjësia për ruajtjen, administrimin dhe përdorimin e dokumentacionit kalon te shoqëria përfituese nga momenti i nënshkrimit të procesverbalit.

Neni 13

Përfundimi i veprimtarisë së shoqërisë shtetërore pasuese

1. Shoqëria shtetërore pasuese krijohet me kohëzgjatje të përcaktuar deri në përfundimin e proceseve të administrimit dhe shitjes së aseteve, arkëtimit të kërkesave dhe shlyerjes së detyrimeve të transferuara, sipas këtij ligji.

2. Pas përfundimit të proceseve të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, shoqëria shtetërore pasuese i nënshtrohet procedurës së likuidimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për shoqëritë tregtare.

3. Pasuritë, asetet ose të drejtat pasurore që mbeten pas përfundimit të likuidimit dhe shlyerjes së detyrimeve u shpërndahen aksionarëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi për shoqëritë tregtare dhe aktin e themelimit të shoqërisë.

4. Këshilli i Ministrave përcakton procedurat e hollësishme për përfundimin e veprimtarisë dhe likuidimin e shoqërisë shtetërore pasuese.

KREU IV

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 14

Aktet nënligjore

Këshilli i Ministrave nxjerr aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi, në zbatim të neneve 7, pikat 4 dhe 7, dhe 8 të këtij ligji.

Neni 15

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.
Miratuar në datën 23.7.2026.

Shpallur me dekretin nr. 457, datë 30.7.2026, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.